

Në bazë të nenit 172 të Ligjit për arsimin e lartë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 82/2018“ dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 178/2021“), Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës, shpallet

KONKURS

për zgjedhjen-rizgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në Universitetin e Tetovës

Shpallet Konkurs për zgjedhjen-rizgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në Universitetin e Tetovës:

FAKULTETI PEDAGOGJIK

1. Një mësimdhënës në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në lëmin Pedagogji sociale (50518 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit).
2. Një mësimdhënës në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në lëmin Defektologji (50521 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit).

FAKULTETI JURIDIK

1. Një mësimdhënës në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në lëmin E drejta financiare, Sistemet politike bashkëkohore (50812, 50831 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit).

FAKULTETI I ARTEVE

1. Një mësimdhënës në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore për lëndët profesionale-artistike në lëmin e Vizatimit (60700 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit).
2. Një mësimdhënës në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore për lëndët profesionale-artistike në lëmin Vizatim, Pikturë dhe teknikat e pikturës (60700, 60701 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit).
3. Një mësimdhënës në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore për lëndët profesionale-artistike në lëmin Metodika e edukatës figurative, Pikturë dhe teknikat e pikturës (60708, 60701 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit).
4. Një mësimdhënës në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore për lëndët profesionale-artistike në lëmin Të tjera (60712 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit).

5. Një mësimdhënës në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore për lëndët profesionale-artistike në lëmin Arti i klasicizmit-i përgjithshëm, Arti i klasicizmit-nacional, Arti i romantizmit-i përgjithshëm, Arti i romantizmit-nacional, Arti i realizmit – i përgjithshëm, Arti i realizmit – nacional, Arti i shekullit XX (impresionizmi, kubizmi,, fovizmi, mbirealizmi, dadaizmi) (60609, 60610, 60611, 60612, 60613, 60614, 60615 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit).
6. Një mësimdhënës në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore për lëndët profesionale-artistike në lëmin Historia e muzikës, Teknikë vokale, Solo këndim (60901, 60913, 60911 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit).
7. Një mësimdhënës në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore për lëndët profesionale-artistike në lëmin Llojet e instrumenteve-harkorë, piano, harfa, harmonika, frymor, me goditje etj. (60910 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit).

Kushtet për thirrjen mësimore-shkencore docent, profesor inordinar dhe profesor ordinar:

- Thirrje mësimore – shkencore, me Vendim të organit kompetent, nëse e posedon;
- Diplomë për kryerjen e studimeve deridiplomike;
- Diplomë për kryerjen e studimeve të magjistraturës;
- Diplomë për gradën shkencore doktor i shkencave nga fusha shkencore në të cilën zgjidhet;
- Kandidatët që konkurrojnë duhet të kenë kontinuitet në studimet nga fusha përkatëse;
- Listë të punimeve shkencore dhe publikimeve profesionale të botuara, si dhe kopje të punimeve të publikuara;
- Biografi e shkurtër;
- Ta dorëzojë punimin e doktoratës;
- Vërtetim për njohjen e një gjuhe të huaj;
- Njohje të gjuhës shqipe - shkrim dhe lexim;
- Certifikatë nga libri amë i të lindurve;
- Certifikatë e shtetësisë.

Kushtet për thirrjen mësimore-shkencore në lëndët profesionale-artistike docent, profesor inordinar dhe profesor ordinar:

- Thirrje mësimore – shkencore, me Vendim të organit kompetent, nëse e posedon;
- Diplomë për kryerjen e arsimit të lartë dhe marrjen e gradës shkencore magjistër i shkencave nga fusha shkencore në të cilën zgjidhet;
- Kandidatët që konkurrojnë duhet të kenë kontinuitet në studimet nga fusha përkatëse;
- Listë të punimeve shkencore dhe publikimeve profesionale të botuara, si dhe kopje të punimeve të publikuara;
- Biografi e shkurtër;
- Ta dorëzojë punimin e magjistraturës;
- Vërtetim për njohjen e një gjuhe të huaj;

- Njohje të gjuhës shqipe - shkrim dhe lexim;
- Certifikatë nga libri amë i të lindurve;
- Certifikatë e shtetësisë.

*Kandidatët duhet t'i plotësojnë kushtet për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore dhe në thirrje mësimore-shkencore për lëndët profesionale artistike, të parapara me nenet 166 dhe 167 të Ligjit për arsimin e lartë.

*Fletëparaqitjen bashkë me dokumentet e nevojshme, kandidati duhet t'i dorëzojë në afat prej 5 ditë pune, nga dita e shpalljes së Konkursit, në Rektoratin e Universitetit të Tetovës, në adresën: Rektorati i Universitetit të Tetovës, Rr. e Ilindenit, p.n. Tetovë.

Universiteti i Tetovës